
 Republika e Kosovës Republika Kosovo	ZYRA E PERSONELIT KANCELARIJA OSOBLJA		 Komuna e Istogut Opština Istok
	02 Nr.239 /18	Data: 14.11.2018	

Në bazë të nenit 8 paragrafi 1. dhe 2. të Ligjit të Punës së Republikës së Kosovës Nr.03/L-212, Komuna e Istogut ,shpall:

K o n k u r s

Për kryerjen e punëve me kontratë për kohë të caktuar

Vendi i punës: Mjek i Mjekësisë së Përgjithshme në QKMF

Institucioni : Qendra Kryesore e Mjekësisë Familjare

Numri i Ekzekutuesve: 1 (një)

Numri i referencës:02Nr239/18

Paga mujore: 565 € në muaj

Kohëzgjatja e Emrimit : Me afat të caktuar - 1 (një) vit

Orari i plotë : 40 orë në javë

Detyrat :

- 1.Sigurimi i shërbimeve shëndetësore në mbrojtjen parësore;
- 2.Kujdeset për shëndetin e pacientëve, përshkruan dhe administron tretmanët, medikamentet dhe i zbaton masat tjera shëruese;
- 3.Ndihmon në parandalimin e sëmundjeve dhe çregullimeve duke këshilluar pacientët dhe popullaten në lidhje me pastërtinë dhe shëndetin në përgjithësi;
- 4.Përshkruan dhe administron medikamentet;
- 5.Udhëzon pacientët te specialistët mjekësorë dhe shkëmben të dhënat relevante mjekësore;
- 6.Përpilon me shkrim lidhur me punën dhe veprimet e tij;
- 7.Ndërmerr aktivitete për edukimin shëndetësor të popullatës;
- 8.Ndihmon dhe siguron mirësjellje e kujdes të veçantë në lëminë në të cilën është trajnuar
- 9.Mbanë kujdestarin sipas radhës dhe kryen punë tjera sipas kërkesë së mbikëqyrësit.

Kualifikimet, shkathtësit kyqe, aftësit dhe përvoja.

- Fakulteti i Mjekësisë, dega e Mjekësisë së Përgjithshme;
- Minimum stazhi i Obliguar Profesional;
- Të jetë i licencuar.
- Përvoja e punës e dëshirueshme.

Dokumentët e kërkuara:

- Diploma e Fakultetit të Mjekësisë;
- Çertifikatën e Liçencës;
- Dëshmi për përvojen e punës;
- Dokumentin e identifikimit;
- Çertifikata që nuk jeni nën hetime.

Konkursi duhet të jetë i barabartë për të gjithë kandidatët e synuar, pa asnjë lloj diskriminimi ashtu qysh parashihet me Ligjin nr.03/L-212 të Punës.

Paraqitja e kërkesave : Aplikacionet merren në Qendrën për Shërbim me Qytetar, kati i I-rë, Zyra nr.100 dhe kërkesat e plotësuara dorëzohen personalisht në të njëjtën zyre.

Afati i aplikimit: Konkursi është i hapur pesëmbdhjetë (15) ditë kalendarike nga data e publikimit.

Data e shpalljes së konkursit: 14.11.2018 deri më datë : 28.11.2018

Aplikacionet e dorëzuara pas afatit nuk pranohen dhe aplikacionet e mangëta refuzohen.

Vetëm kandidatët e përzgjedhur në listën e shkurtër do të kontaktohen.

Menaxheri i Personelit
Fatmir Bytyci

